

Gjendja financiare e tregut të sigurimeve gjatë vitit 2007

Viti 2007 u karakterizua kryesisht nga zhvillime pozitive dhe një qëndrueshmëri e tregut të sigurimeve në përgjithësi. Gjendja financiare e tij vlerësohet e mirë, me ecuri të kënaqshme të treguesve të rentabilitetit (RoE, RoA), përmirësim të aftësive të tregut të sigurimeve për të mbuluar me kapital humbjet e mundshme nga përgjegjësitë e kontraktuara si rrjedhojë e rritjes së kapitalit minimal në formën e fondit të garancisë, mjaftueshmëri kapitali mbi nivelin minimal të përcaktuar nga legjislacioni në fuqi në masën 137 %, si dhe aktive të mjaftueshme për mbulimin e përgjegjësisve ndaj policmabajtësve për aktivitetin e Jetës dhe të Jo Jetës, përkatësisht në masën 158.66 % dhe 128.10 %. Aftësia paguese e tregut pati një prirje rritëse me 1.1 miliardë lekë nga 3.4 miliardë lekë në vitin 2006 dhe 4.5 miliardë lekë në vitin 2007, duke ndikuar në rritjen e kapacitetit mbajtës të tregut të sigurimeve, kapacitetit investues, si dhe në rritjen e cilësisë së marrëveshjeve të risigurimit. Raporti i aftësisë paguese është në nivele të larta, rreth 539.19 % në nivel tregu. Krahasimi i këtij raporti me raportin e kapitalit ndaj fondit të garancisë, përforcon nevojën e përfshirjes së metodologjive mbikëqyrëse më komplekse nga ana e AMF, metodologji të cilat në thelb duhet të kenë analizën e riskut, duke ndjekur kështu tendencat mbarëglobale dhe praktikatat më të mira në këtë drejtim.

Gjatë vitit 2007, aktivet e tregut të sigurimeve u rritën me 1.91 miliardë lekë ose 16.65 %. Rritja vlerësohet rreth 0.67 miliardë lekë më e lartë se ajo e vitit 2006 dhe është reflektuar kryesisht në rritjen e peshës së investimeve në depozita me rreth 50.42 %, ose me 1.63 milionë lekë. Në fund të vitit 2007, kapitali aksioner i tregut arriti në 6.9 miliardë lekë, çka shënoi një rritje me 1.3 miliardë lekë ose 25.17 % krahasuar me vitin 2006. Ndërkohë, krahasuar me fundin e vitit 2005, rritja paraqitet rreth 2.2 miliardë lekë ose 46.80 %. Totali i aktiveve të financuara nga kapitali aksioner në fund të vitit 2007 paraqet një rritje rreth 6.65 %.

Rezultati neto i tregut të sigurimeve për vitin 2007, raportohet rreth 0.73 miliardë lekë, nga 0.68 miliardë lekë një vit më parë apo 8.24 % më i lartë. Vlen për t'u theksuar fakti që si tregu i sigurimeve të Jetës dhe ai i Jo Jetës paraqesin një rezultat teknik pozitiv përkatësisht në vlerat 119.7 milion lekë dhe 540.7 milion lekë.

Rritja e ndjeshme e kapitalit të tregut të sigurimeve për vitin 2007 dhe niveli ende i ulët i raportit të primeve të shkruara bruto ndaj PBB në masën 0.61 %, përforcojnë mendimin se tregu shqiptar i sigurimeve paraqet potencial të madh për zhvillim në të ardhmen. Një gjë e tillë vihet re dhe po të analizohet raporti i kapitalit (kapitali ndaj primeve të shkruara bruto), i cili për vitin 2007 është në masën 74.84 %, jashtë diapazoneve të rekomanduara nga sistemi IRIS, që janë në një interval 50 deri 20 %. Kjo gjë shpjegohet me faktin se tregu shqiptar i sigurimeve ka kapital më se të mjaftueshëm për nivelin aktual të biznesit dhe se ka ende potencial të pashfrytëzuar për rritjen e biznesit.

Problematik vazhdon të jetë raporti i ulët dëme/prime dhe raporti i lartë i shpenzimeve, përkatësisht në masën 24.19 % dhe 55.62 %. AMF ka ndërmarrë një sërë masash gjatë vitit 2007, të cilat pritet të sjellin efektet e tyre në përmirësimin e cilësisë së trajtimit të dëmeve dhe efektivisht në rritjen e këtij raporti. Përkatësisht janë miratuar dhe kanë hyrë në fuqi dy udhëzime për trajtimin e dëmeve, bazuar në standartet e OECD si dhe një VKM për licencimin e vlerësuesve të pavarur të dëmeve në sigurime. Gjithashtu, vëmendje e veçantë i kushtohet trajtimit të ankesave të ndryshme, krahas detyrimit të vendosur të shoqërive të sigurimit për mbajtjen e një baze të dhënash për ankesat e konsumatorëve, e cila do të jetë në monitorim të vazhdueshëm nga Autoriteti.